

**PROGRAM
MËSIMOR**

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



**ARSIM FIZIK DHE
SHËNDETËSOR**

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të udhëheqjes shtetërore („Gazeta zyrtare e RM”nr. 58/00 dhe 44/02 dhe neni 24 dhe 26 i Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e RM “nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 dhe 51/07), ministri i Arsimit dhe Shkencës ka caktuar programin mësimor nga lënda e *arsimit fizik dhe shëndetësor* për klasën VIII për arsimin fillor tetëvjeçarë, gjegjësisht për klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçarë.

1. HYRJJE

Në periudhën e tretë në arsimin fillor nëntëvjeçarë (klasa e VII – IX) arsimi fizik dhe shëndetësor është lëndë e detyrueshëm me 3 orë në javë, gjegjësisht 108 orë në vit.

Programi për arsim fizik dhe shëndetësor për klasën e VII ndërlidhet me programin mësimor për klasën e VI. Programi për arsim fizik dhe shëndetësor në procesin arsimor realizohet me përmbajtje të caktuara, ushtrime dhe lojëra të cilët fizikisht e aktivizojnë aparatit lokomotor dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen simetrike dhe të drejtë, e përmirëson aftësinë e tij fizike dhe shëndetin dhe i nxit në mënyrë të shëndetshme të jetesës. Gjithashtu, janë të përfshirë aktivitete përmes të cilave nxënësit kanë qasje në lëvizjet themelore dhe teknikat e lojërave të caktuara sportive.

Aktivitetet e planifikuara nga ky program e nxisin dhe zhvillojnë zhvillimin kognitiv, psikomotor dhe emocional dhe social të nxënësve.

Programi mësimor është me qasje demokratike dhe komponenta, me qëllime t'i lirojë nxënësit nga stresi përmes ushtrimeve.

VËREJTJE:

Në pajtim me dinamikën për inkuadrimin e edukimit dhe arsimet fillor nëntëvjeçarë, programi mësimor për nxënësit e klasës së VI-të arsimet fillor tetëvjeçarë nga viti shkollor 2008/2009 është ekuivalent me programin mësimorë për klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçarë.

2. QËLLIMET E PERIU DHËS ZHVIL-LIMORE PREJ KLASËS SË VII DERI TË IX

Nxënësi/ nxënësja:

- të perfeksionojë ushtrime për zhvillim të drejtë dhe simetrik, qëndrim të drejtë të trupit në të gjithë pozitat dhe funksionim të drejtë të aparatit lokomotor;
- të zbatojë dhe perfeksionojë ushtrime të drejta dhe të koordinuara për përforsim, relaks dhe shtrirje si dhe elemente të sporteve për krijimin e bazave në sport.
- ta zbatojë dhe zhvillojë koordinimin dhe orientimin lokomotor në hapësirë me ushtrime dhe kompleks ushtrime.
- të merr pjesë aktive në përforsimin dhe përvetësimin e ushtrimeve të reja dhe elemente të bazave të sporteve dhe në lojëra (stafetore, vallëzime, lojëra pa kufi, poligone etj);
- t'i pasurojë njohuritë e veta sportive me përvetësimin e teknikave të zbatuara drejtë dhe elementeve të bazave të atletikës, gjimnastikës, ritmikës, vallëzimeve dhe bazat e lojërave sportive;
- t'i din rregullat e lojërave, të merr pjesë të barabartë dhe bashkëpunojë në ekip;
- të zhvillojë qëndrime pozitive, shprehi higjienike – shëndetësore raport dhe dashuri për ruajtjen e shëndetit dhe kujdesin e trupit;
- të zhvillojë aftësi komunikative psikosociale dhe interpersonale;
- të zhvillojë shkathtësi për shprehje pozitive emocionale në gara.

3. QËLLIMET E MËSIMIT PËR KLASËN E VII

Nxënësi/nxënësj:

- të ekzekutojë ushtrime për zhvillimin e drejt fizik (formimi i trupit) dhe zhvillimi i motorikes bazë për lëvizje dhe marrje me sport;
- ta mbajë trupin në mënyrë të rregullt në të gjitha pozitat, edhe atë:ndenjur, drejtë qëndrim, lëvizje(ecje dhe vrapim);
- t'i ushtroj dhe perfeksionoj teknikat e vrapimit, kërcimit së gjati dhe së larti, me ndikime pozitive mbi zhvillimin e aftësive funksionale dhe motorike;
- t'i ushtroj dhe perfeksionoj njohuritë bazë sportive-teknike të gjimnastikës dhe ritmikës;
- të përvetësojë dhe ekzekutojë gjer më tre valle popullore nga vendlindja dhe vallëzime moderne, zhvillimi i aftësive motorike në përputhshmëri me ritmin e muzikës;
- t'i përvetësojë dhe perfeksionojë njohuritë sportive-teknike dhe taktike nga futboli, ta mirëmbajë dhe zhvillojë psikomotorikën e përgjithshme, si dhe motoriken specifike;
- ta përvetësojë njohurinë sportive-teknike nga volejboli, ta mirëmbajë dhe përmirësojë motorikën e përgjithshme, si dhe motorikën specifike të lëvizjes me krahët dhe trungun në raport me topin;
- të bashkëpunojë dhe merr pjesë në aktivitetin ekipor, të posedojë fer-plej aftësi dhe sjellje gjatë garimit;
- të lirohet prej stresseve dhe ngarkesave psikike dhe fizike në lojërat kolektive dhe gjatë garimit;
- të krijojë dhe zbatojë shprehi higjienike-shëndetësore gjatë të ushtruarit dhe marrjes me sport për mirëmbajtjen dhe përparimin e shëndetit dhe higjienës personale;
- në mënyrë të rregullt t'i zbatojë nocionet nga lëmi edukative-arsimore, arsimi fizik dhe shëndetësorë(rekuizita sportive, vegla dhe ndihmesa tjera).

4. QËLLIMET KONKRETE

TEMA: USHTRIME DHE LOJËRA PËR ZHVILLIM TË DREJT FIZIK DHE PËRGATITJE

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zbatojë ushtrime për zgjatje, përforsim dhe relaksim të muskujve, për formimin e trupit dhe zhvillimin e lëvizshmërisë; - ta përmirësojë përgatitjen e përgjithshme fizike me ekzekutim të drejtë të ushtrimeve me ndikim pozitiv në zhvillimin e aftësive anatomiko- fiziologjike, funksionale dhe motorike; 	<ul style="list-style-type: none"> - Kompleks ushtrimesh për: <ul style="list-style-type: none"> - brezin e supeve, qafën dhe gjymtyrët e sipërme - trungun (muskulaturën e stomakut dhe të shpinës) - ushtrime për pjesën e kërdhokullave dhe gjymtyrët e poshtme - Kompleks ushtrimesh në tokë me kërcime pupthi, kërcime në vend dhe lëvizje, - Kompleks ushtrimesh në shpinore dhe vegla të tjera - Kompleks ushtrimesh me rekuizita për zhvillimin e forcës, për zgjatje dhe relaksim - Lojëra elementare dhe stafetore 	<ul style="list-style-type: none"> - Përforsimi i muskulaturës. - Relaksimi - Përgatitja fizike e përgjithshme sportive 	<ul style="list-style-type: none"> - Ushtrime për formimin e trupit dhe të lëvizjeve. - Dozimi i ushtrimeve, në veçanti në vrapimin për qëndrueshmëri e cila duhet të jetë e kahëzuar sipas aftësive të nxënëseve. - Kompleks ushtrimesh për të gjithë grup muskujt e trupit(brezi i supeve, qafës dhe ekstremitet e sipërme, muskulatura e trupit- stomakut dhe shpinës dhe muskulatura e brezit të kërdhokullave dhe gjymtyrët e poshtme. - Ekzekutimi i ushtrimeve në drejtqëndrim dhe ndenjor me karakter statik dhe dinamik, lloje të kërcimeve pupthi dhe kërcime në vend dhe lëvizje, shfrytëzim i rekuizitave në mënyrë të kombinuar. - Kompleks ushtrimesh dhe lëvizje për ndikim preventiv në paraqitjen e deformiteteve. - Lojëra elementare dhe stafetore.

TEMA: ATLETIKË

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'i ushtrojë dhe përvetësojë elementet e atletikës: teknikën e vrapimit, kërcimit dhe hedhjes; - ta zhvillojë dhe përvetësojë koordinimin e përgjithshëm dhe koordinimin me duart dhe këmbët; - t'i zhvilloj aftësitë për vrapim të qëndrueshëm(qëndrueshmëri dhe aftësi aerobe); - ta mirëmbajë dhe zhvillojë aftësinë për vrapim të shpejtë dhe zhvillim i aftësive aerobe dhe anaerobe, (shpejtësia e lëvizjes dhe eksplozivitet); - t'i ushtojë dhe perfeksionojë kërcimet së gjati dhe së larti(zhvillimi i kërcyeshmërisë, koordinimit dhe eksplosivitetit); - ta zhvillojë forcën e grup muskujve të gjymtyrëve të sipërme, brezit të supeve dhe qafës, zhvillimi i precizitetit dhe koordinimit të trupit në hapësirë. 	<p>Vrapim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - perfeksionimi i teknikës start të lartë me vrapim qëndrueshmërie; - perfeksionimi i teknikës start i lartë me vrapim të shpejtë; - perfeksionim i vrapimit shtafetor. <p>Kërcime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kërcim së larti prej vendi; - kërcim në lartësi me hov - së gjati-„hark” - së larti-„teknika stredëll” - bazat e teknikës <p>Shtytje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shtytja e gjyles, 1 kg, „ teknika shkollore; - hedhja e topit në cak dhe në largësi” - Lojëra stafetore dhe poligone (me përdorimin e veglave dhe rekuizitave). 	<ul style="list-style-type: none"> - Bllloqe sportive - Rrugica atletikore - Teknika në atletikë - Teknika „stredëll” 	<ul style="list-style-type: none"> - Perfeksionimi i startit të lartë pas dhënies së shenjës: në vende/nis/vrapo. - Vrapim qëndrueshmërie në 500 dhe 600m. - perfeksionimi i startit të ulët me shfrytëzimin e të tri shenjave, edhe atë: në vende, përgatitu/start(mësimdhënësi kujdeset për nisjen me intencë për nisje të shpejtë dhe eksplozive). - Ekzekutim i teknikave të kërcimeve atletikore së gjati dhe së larti në katër faza(vrull, shtytje, fluturim dhe rënie) me matjen e gjatësisë dhe lartësisë të kërcimeve. - Kërcimi i pengesave. - Zbaton lojëra shtafetore, poligone etj.

TEMA: GJMNASTIKA DHE RITMIKA

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ta përvetësojë, ushtrojë dhe përforcojë teknikën e elementeve prej – akrobatika, varje dhe lëkundje në unaza, elemente në paralele dhe paralele të shkallëzuara, kapërcim në kaluç, kalë dhe sanduk suedez, tra i ulët dhe ritmikë; - t'i perfeksionojë teknikat e kapërcimit; - ta zhvillojë forcën e grup muskujve të gjymtyrëve të sipërme dhe brezin e supeve; - ta përmirësojë motorikën e përgjithshme dhe koordinimit të lëvizjes në hapësirë; - ta zhvillojë ekuilibrin; - të aftësohet për ecje dhe vrapim ritmik të koordinuar dhe të zhvillojë mbajtje estetike të trupit gjatë lëvizjeve në hapësirë; - të aftësohet për kërcime pupthi dhe kërcime ritmike të koordinuara dhe për lëvizje ritmike gracioze në hapësirë të harmonizuara me muzikë. 	<p>Akrobatikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teknika e perfeksionimit rrotullim anash „ylli” - vertikale mbi duar - kërcime ritmike - kombinime nga elementet e përvetësuara <p>Kapërcime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teknika e kapërcimit këmbë hapur, dhe këmbë mbledhur mbi kalë hekur gjmnastikor - perfeksionimi i teknikës së lëkundjes në varje; - në lëkundje para kapje me nëngjurin e djathtë - teknika e kthimit në mbështetje shaluar para dhe prapa <p>Unazat (të ulta):</p> <ul style="list-style-type: none"> - varje dhe ndrimi i varjeve - lëkundje në varje para 	<ul style="list-style-type: none"> - unaza - paralele për meshkuj dhe paralele të shkallëzuara për femra - mbështetje - hov 	<ul style="list-style-type: none"> - Ushtrime nga gjmnastika: akrobatikë, kërcime mbi kaluç, ushtrime mbi trarë të ulët dhe varje në unaza, paralele dhe hekur gjmnastikor. - (Mësimdhënësi i përkushton rëndësi të veçantë në asistimin gjatë ekzekutimit të ushtrimeve.) - Lojëra stafetore dhe poligone me elemente të përvetësuara nga atletika dhe gjmnastika. - Ushtrime për zgjatje dhe preventivë për paraqitje të deformiteteve trupore. - Aktivitete të veçanta dhe metoda gjatë ekzekutimit të ushtrimeve tek nxënësit që kanë frikë dhe pasiguritet. - Kompleks ushtrimesh nga gjmnastika korrektive për nxënës me deformitete trupore, si dhe komplekse ushtrimesh preventive për nxënës me predisponim ndaj deformiteteve trupore.

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
	<p>-paralele(meshkuj); - lëkundje nga mbështetja mbi krahë dhe mbështetja</p> <p>Kalë me doreza: - kërcim me lëkundje; - kërcim lëkundje dhe hapërim me një rën madje me tjetrën këmbë.</p> <p>- paralele të shkallëzuara; - ngritje dhe kthim në drushtën e ulët me rrotullim para.</p> <p>- Trau i ulët - ecje me kërcime pupthi mbi traun e ulët; - ecje dhe kthim me përkulje në një rën këmbë për 180° - kërcime pupthi sipas dëshirës</p> <p>Ritmikë: - perfeksionimi i qëndrimeve - ecje dhe vrapim ritmik - kërcime pupthi ritmike: fëmijërore, të maces dhe kërcime në lartësi dhe gjatësi</p> <p>- kombinime të ecjes ritmike, kërcimeve pupthi, vrapim me dhe pa rekuizitë me muzikë - ushtrime ritmike me rekuizitë. - poligon</p>		<p>- Poligone.</p> <p>- Kombinimi i qëndrimeve ritmike prej elementeve të mësuara me dhe pa rekuizita.</p>

TEMA: VALLËZIME

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përvetësojë, ushtrojë dhe perfeksionojë valle popullore dhe vallëzime moderne sipas dëshirës me ngacmimin e ndjenjave emocionale pozitive dhe zhvillimi i aftësive motorike në korrelacion me muzikën dhe ritmin e lëvizjes; - ta zhvillojë komponentët estetikë për qëndrim dhe mbajtjen e trupit; - t'i zhvillojë aftësitë funksionale dhe psikomotore dhe motorikes së përgjithshme të aparatit lokomotor. 	<p>Valle popullore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përvetësim dhe ekzekutim të tri valleve popullore sipas dëshirës së nxënësve dhe mësimdhënësve (mënyra të mbajtjes për duar dhe lëvizje në hapësirë ; - mbajtja e trupit gjatë vallëzimit; - hapat në vallëzimet) <p>Vallëzime moderne:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vallëzime moderne sipas dëshirës(2) 	<p>Emrat e valleve popullore dhe vallëzimeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përsëritja e valleve popullore të mësuara dhe të vallëzimeve moderne. - Përvetësimi i hapave, lëvizjeve dhe luajtja e tri valleve popullore, karakteristike për traditat të trevave ku jetohej (të zbatohen valle dhe vallëzime me temp të ngadalshëm dhe të shpejtë).

TEMA: LOJËRA SPORTIVE - VOLEJBOLL

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ushtrojë dhe perfeksionojë qëndrime dhe lëvizje bazë volejbollike, teknika bazë të pasimit dhe pranimit të topit në vend dhe lëvizje; - ta zhvillojë motorikën manipulative të reagimit të shkathët; - të zhvillojë lëvizje motorike të ekstremiteteve dhe koordinim specifik (volejbolistik) në hapësirë; - ta zhvillojë koordinimin dhe ekuilibrin të aparatit lokomotor në përgjithësi; - ta zhvillojë precizitetin e duarve, frymën garuese dhe fer-plej ; 	<p>Dëbim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dëbimi i topit mbi kokë me gishtërinj - dëbimi i topit me partner - pranimi i topit prej drejtimeve dhe lartësive të ndryshme; - dëbimi i topit në drejtime të ndryshme - dëbimi i topit me teknikën „çekan” <p>Shërbime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shërbim, teknika shkollore Lojë mbi rrjetë - në dyshe dhe treshe - zbatimimi i elementeve të përvetësuara nga volejboli në lojëra stafetore 	<ul style="list-style-type: none"> - Volejboli si lojë sportive; - Qëndrimet volejbolistike; - Refuzimi me gishta; - Çekani 	<ul style="list-style-type: none"> - Demonstrimi i qëndrimeve në volejball. - Refuzimi i topit me dy duar mbi kokë dhe kah nxënësi tjetër. - Dëbimi i topit në lartësi të ndryshme dhe pozitive të ndryshme të trupit - Lojë mbi rrjetë me zbatimin e rregullave më elementare volejbolistike të dëbimit të topit në dyshe dhe treshe. - Lojëra shtafetore dhe poligone me elemente të mësuara nga volejboli.

TEMA: LOJËRA SPORTIVE - BASKETBOLL

Qëllime	Përmbajtje	Koncepte	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të perfeksionojë dhe përforcojë qëndrimet dhe lëvizjet themelore të basketbollit teknikat themelore të zhonglimit dhe driblingut të topit në vend dhe lëvizje. - ta zhvillojë motorikën manipuluese në reagim; - të zhvillojë lëvizje motorike të gjymtyrëve dhe koordinimit specifik (basketbollistik) në hapësirë; -të zhvillojë forcë eksplozive të muskulaturës së duarve dhe këmbëve; - ta zhvillojë precizitetin; - ta zhvillojë precizitetin me duar, frymën e garimit korrekt dhe fer-plej. - ti mësojë dhe zbatojë rregullat e lojërave të basketbollit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Zhonglim dhe dribling me top; - Zhonglim dhe dribling i topit në vend dhe në lëvizje (në lartësi të ndryshme nga trupi) me një dhe dy duar; - Zhonglim me top - Dribling - Ndalimi i lojtarit me top - Lëvizje në sulm me dhe pa top - Aktivitetet lëvizëse të lojtarit në lëvizje Aktivitete kolektive dhe individuale të lojtarit në sulm dhe mbrojtje 	<ul style="list-style-type: none"> - Dyhapëshi - Gabim personal - Reket basketbolli - 3 sekonda 	<ul style="list-style-type: none"> - Qëndrime dhe lëvizje basketbollistike, pa dhe me top, dribling dhe zhobling me top në vend (me ndryshim të largesës). - Dribling dhe zhonglim në lartësi të gjoksit. - Dribling dhe zhonglim mbi kokë, dribling dhe zhonglim i topit në çifte në lëvizje me mbizotërimin e hapësirës, zhonglim dhe dribling i kombinuar i topit me udhëheqjen. - Udhëheqja e topit në vend dhe lëvizje (në vijë të drejtë), udhëheqje me ndryshimin e drejtimit dhe intensitetit, udhëheqja e topit me dorën e majtë dhe dorën e djathtë në mënyrë të pandryshuar përmes pengesave, dribling dhe zhonglim i kombinuar, zënia e topit në kosh. - Demonstrim lëvizjesh – zhonglim, dribling. - Ushtrime - zhonglim, dribling. - Gjuajte në kosh nga vendi dhe në lëvizje me udhëheqjen e topit (me dhe pa kërcim) gjuajtje të kombinuara. - Lojë në një dhe dy kosha me inkuadrim të ngadalshëm të elementeve tekniko-taktike dhe kombinime.

TEMA MËSIMORE - LËMIJË TË CILËT REALIZOHEN NË MARRË- VESHJE ME PRINDËRIT:

- NOT ME AKTIVITETE NË UJË DHE MËSIM I ELEMENTEVE BAZËI
- SKIJIM ME MËSIM TË ELEMENTEVE BAZË
- PING-PONG
- SHËTITJE(ME ECJE, BIÇIKLETA)
- SPORTI SHKOLLOR
- SHKOLLAT SPORTIVE
- ALPINIZËM
- VELOSIPEDIZMI
- ROLERË
- MINI TENIS
- BADMINTON

5. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Programi mësimor për arsim fizik dhe shëndetësor për nxënësit e klasës së Programi mundëson kontinuitet të programeve mësimore të mëparshme me vendosjen e specifikave të moshës dhe të përbajtjeve të cilët vijnë si vendosje në temat duke i sintetizuar elementet e mësuara nga sportet dhe elementet e reja të cilët duhet në mësim të mësohen në përputhshmëri me aftësitë e nxënësve me qëllim që të arrihet kualitet më i lartë në mësim dhe spektër më i gjerë të elementeve të përvetësuara nga sportet dhe arritja e efekteve shëndetësore.

Tema e parë Ushtrime dhe lojëra për zhvillim dhe përgatitjen e drejtë fizike, ngel si nevojë bazë dhe e përgjithshme për nxënësit për ngritjen permanente të aftësive të përgjithshme dhe lëvizshmërisë së aparatit lokomotor dhe organizmit në përgjithësi, për të cilën mësimdhënësit duhet të

kenë kujdes të veçantë në zgjedhjen dhe ndikimin e ushtrimeve, elementet dhe lojërat me dozim të matur dhe laramani në punë të përmbahet dhe përparoj interesi për të ushtruarit. Mësimdhënësit duhet të kushtojnë kujdes të veçantë nxënësit në mënyrë të drejtë t'i ekzekutojnë elementet me rekuizita dhe ndihmesa konform aftësive dhe moshës .

Në klasën e VII temat mësimore Atlatika dhe gjimnastika me ritmikë mësimdhënësi duhet t'i orientojë kah përvetësimi i elementeve të reja, të zbatohen drejtë dhe njëherit ta vetëdijësojë njohuritë sportive në nivel më të lartë.

Mësimdhënësi e përcjell statusin motorik të nxënësve dhe merr masa gjatë paraqitjes eventuale të deformiteteve trupore edhe atë me intensitet të madh dhe për këtë problem përkujdeset me ushtrime trupore adekuate. Për atë shkak në secilën orë të arsimit fizik dhe shëndetësorë patjetër ekzekutohen ushtrime për formimin e trupit dhe të lëvizjeve, ndërsa mësimdhënësi duhet nxënësve t'u jep detyra shtëpie për ushtrim të ushtrimeve trupore për trup dhe lëvizje simetrike. Nxënësit motivohen të ushtrojnë rregullisht dhe drejt dhe ta kultivojnë trupin e tyre .

Pas marrëveshjes me prindërit, mësimdhënësi përgatit program për përbajtjet të zgjedhura – tema – lëmi mësimore.

6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Sipas ligjit për arsim fillor, Konceptit dhe qëllimet e programit mësimor për arsim fizik dhe shëndetësor, të arriturat e nxënësve në klasën e VII vlerësohen numerikisht.

Gjatë formimit të notës numerike mësimdhënësi mban llogari për të gjitha të arriturat e nxënësve në mësim, për arsye se të gjithë ato janë të rëndësishme. Gjegjësisht, ai notën numerike e formon në bazë të angazhimit të nxënësit, njohurisë sportive, përparimit fizik dhe aftësive, angazhimit, rregullsisë, komunikimit, sjelljes fer-plej, bashkëpunimit dhe ndihmës, përmbushjes së kushteve higjienike-shëndetësore dhe shprehive para, gjatë dhe pas realizimit të mësimin. Në arsimin fizik dhe shëndetësor nuk ka kushte të veçanta për notim. Mësimdhënësi gjatë secilës orë i përcjell të arriturat e nxënësit në të gjithë komponentët, i evidenton dhe në bazë të tyre formon notë. Gjatë orës të arsimit fizik dhe shëndetësor mësimdhënësi në veçanti kujdeset mësimin ta realizon pa strese dhe situata stresi, ashtu që nxënësi secilën orë duhet ta përfundojë me ndjenje emocionale pozitive.

Aftësitë fizike tek nxënësit janë të ndryshme, për atë shkak mësimdhënësi prej tyre nuk duhet të kërkon dhe vendos norma sido qofshin ato për notë. Secili individualisht notohet në bazë të angazhimit dhe aftësive, rregullsisë dhe elementeve të tjera. Indikatorët e shëndetit (aftësitë psikomotorë dhe funksionale) nuk janë norma për notim, ata janë elemente që të dijë mësimdhënësi se sa duhet ta ngarkon nxënësin në kufij të ndikimit pozitiv

7. KUSHTET HAPËSIRORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi krahas kushteve hapësinore themelohet në normativin për hapësirë, përgatitjes dhe mjeteve mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçarë në shkollat fillore të caktuar nga ministri i Arsimit dhe shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 prej 28.02.2008.

8. NORMATIVI PËR KUADRIN ARSIMOR

Për realizimin e programit mësimor për arsim fizik dhe shëndetësor për klasën e tetë janë paraparë mësimdhënës me fakultet të kryer për kulturë fizike – drejtimi arsimor.

Programi mësimor për *arsim fizik dhe shëndetësorë* për klasën e VIII-të për arsim fizik tetëvjeçarë, gjegjësisht për klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçarë e caktoi ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07. 2326/1 prej 15.03.2008